



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 18 dhjetor 2025
Kodi i ZRRE-së: V_2994 _2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Mbështetur në Nenin 9, 15, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-084 Për Rregullatorin e Energjisë; Nenin 3 paragrafi 1.72 dhe Nenin 37 të Ligjit Nr. 05/L-085 Për Energjinë Elektrike; Nenin 64 par. 2 të Ligjit Nr. 08/L-182 Për Konfliktet Administrative; Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në lëndën P.A.nr.18/2025 të dt. 05.11.2025, Detyrimin institucional për të garantuar siguri të furnizimit, transparencë, mbrojtje të konsumatorit dhe funksionim të qëndrueshëm të tregut dhe Direktivën 2009/72/CE përkatësisht Neni 3 (3) dispozitat që kërkojnë interpretimin kumulativ të kriterëve për furnizim universal,

në seancën e mbajtur më 18 dhjetor 2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. KONSTATOHET** - se Neni 8 i Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike, i miratuar në vitin 2017, si dhe Neni 2 i ndryshimeve dhe plotësimeve të këtij Udhëzuesi të viteve 2018–2019, nuk janë më pjesë e rendit juridik, pasi janë shfuqizuar drejtpërdrejt nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës me Aktgjykimin P.A.nr.18/2025.
- II.** Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës me Aktgjykimin P.A.nr.18/2025, ka bërë interpretimin e detyrueshëm të Nenit 37 paragrafi 2, në lidhje me Nenin 3 paragrafi 1.72 të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, në përputhje me Nenin 3(3) të Direktivës 2009/72/EC, duke sqaruar se e drejta për shërbim universal u takon konsumatorëve familjarë dhe vetëm ndërmarrjeve të vogla që i plotësojnë kumulativisht kriteret ligjore për numrin e punonjësve dhe qarkullimin vjetor.
- III.** ZRRE vazhdon zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike në përputhje me Nenin 3(3) të Direktivës 2009/72/EC, ashtu siç janë interpretuar nga Gjykata Supreme, pa zgjerim apo kufizim përtej kriterëve të përcaktuara nga ligji primar.
- IV.** Ky Vendim është deklarativ dhe konstatues në natyrë dhe nuk krijon, ndryshon apo shfuqizon të drejta ose detyrime të reja për konsumatorët apo pjesëmarrësit në treg.
- V.** Ky Vendim nuk ka efekt retroaktiv dhe nuk ndikon në vlefshmërinë e marrëdhënieve juridike të krijuara në bazë të legjislacionit në fuqi.
- VI.** Ky konstatim bëhet për qëllime të qartësimit institucional dhe transparencës juridike, pa krijuar efekte të reja normative.
- VII.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.



Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji ka shqyrtuar pasojat juridike dhe institucionale që burojnë nga Aktgjykimi i formës së prerë i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, P.A.nr.18/2025, me të cilin janë shfuqizuar dispozita të caktuara të Udhëzuesve për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike të miratuar gjatë periudhës 2017–2019. Në këtë kontekst, ZRRE ka vlerësuar natyrën juridike të aktgjykimit, efektin e tij në rendin juridik dhe obligimet eventuale të ZRRE-së, për ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme rregullative.
- Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, përmes Aktgjykimit të lartcekur, ka shfuqizuar drejtpërdrejt Nenin 8 të Udhëzuesit të vitit 2017 dhe Nenin 2 të ndryshimeve dhe plotësimeve të viteve 2018–2019, duke konstatuar se këto dispozita kanë krijuar paqartësi juridike për konsumatorët për shkak të mungesës së arsyetimit të mjaftueshëm dhe interpretimit të kuadrit ligjor në raport me Direktivën 2009/72/EC.
- Në arsyetimin e Aktgjykimit, veçanërisht në faqen 32, Gjykata Supreme ka bërë interpretimin e detyrueshëm të Nenit 37 paragrafi 2, në lidhje me Nenin 3 paragrafi 1.72 të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, duke iu referuar drejtpërdrejt Nenit 3(3) të Direktivës 2009/72/EC. Gjykata ka sqaruar se e drejta për shërbim universal u takon vetëm konsumatorëve familjarë dhe ndërmarrjeve të vogla – të cilat, sipas përkufizimit të detyrueshëm të Direktivës, janë ndërmarrje me më pak se 50 punonjës dhe një qarkullim vjetor ose bilanc jo më shumë se 10 milionë euro, duke theksuar se ky përkufizim është pjesë integrale e së drejtës evropiane dhe nuk mund të zgjerohet përmes akteve nënligjore. Për rrjedhojë, Gjykata nuk ka konstatuar mungesë të bazës ligjore për liberalizimin e tregut, por vetëm mungesë të arsyetimit në disa dispozita nënligjore të shfuqizuara.
- ZRRE vlerëson se Gjykata Supreme nuk ka vendosur obligim pozitiv për ZRRE-në, për të nxjerrë një akt normativ të ri zëvendësues dhe as nuk ka urdhëruar pezullimin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike. Përkundrazi, Gjykata ka konstatuar se “tregu ligjërisht është i hapur” dhe se zbatimi i ligjit primar dhe i Direktivës 2009/72/EC vazhdon drejtpërdrejt, pa pasur nevojë për ndërhyrje shtesë normative. Në këto rrethana, nxjerrja e një akti normativ të ri për “shfuqizim” ose “zëvendësim” të dispozitave të shfuqizuara do të ishte e panevojshme nga aspekti juridik dhe veprimet procedurale, pasi do të krijonte përshtypjen e gabuar se shfuqizimi i bërë nga Gjykata Supreme nuk ka qenë i mjaftueshëm ose se ZRRE ka kompetencë të rishqyrtojë efektet e aktgjykimit.
- Duke u nisur nga parimi i hierarkisë së normave juridike dhe nga parimi i sigurisë juridike, Bordi vlerëson se veprimi më i përshtatshëm dhe proporcional është nxjerrja e një vendimi deklarativ dhe konstatues, i cili ka për qëllim vetëm evidentimin institucional të faktit se dispozitat e shfuqizuara nuk janë më pjesë e rendit juridik dhe se zbatimi i Ligjit për Energjinë Elektrike dhe i Direktivës 2009/72/EC vazhdon në përputhje me interpretimin e dhënë nga





Gjykata Supreme, ku përcaktohet se shërbimin universal e gëzojnë të gjithë konsumatorët familjarë dhe, kur e shohin të përshtatshme, ndërmarrjet e vogla (ndërmarrje me më pak se 50 punonjës dhe një qarkullim vjetor ose bilanc jo më shumë se 10 milion EUR), të kenë shërbim universal, që do të thotë të drejtën për të furnizuar me energji elektrike me cilësi të caktuar brenda territorit të tyre, me çmime të arsyeshme, të lehta për t'u krahasuar, transparente dhe jo-diskriminuese. Ky vendim nuk krijon norma të reja, nuk prodhon efekte retroaktive dhe nuk cenon marrëdhëniet juridike të krijuara më parë.


- Bordi i ZRRE-së, përmes këtij vendimi, synon të sigurojë qartësi juridike, transparencë institucionale dhe zbatim të njëtrajtshëm të Ligjit të Energjisë Elektrike në frymën e Direktivës 2009/72/EC e cila në formulimin e saj i referohet plotësisht të dy kritereve në mënyrë kumulative, duke shmangur çdo paqartësi në praktikën rregullative dhe çdo interpretim të gabuar se ZRRE ka detyrim të ndërhyjë përtej kompetencave të saj ligjore. Ky qasje është në përputhje me standardet e praktikës administrative dhe gjyqësore evropiane, sipas të cilave aktgjykimet gjyqësore zbatohen drejtpërdrejt dhe organet administrative kufizohen në konstatimin dhe respektimin e tyre. Prandaj, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtar


Arta Isufi, Anëtare


Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Gjykatës Supreme të Kosovës,
- Arkivit të ZRRE-së.